



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E FERIZAJT  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së *Ferizajt*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Mirlinda Beqiri-Udhëheqës ekipi, Ejup Simnica, Besim Lezi dhe Elvir Krasniqi* Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	12
4 Qeverisja e mirë.....	35
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	38
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	47
Shtojca II: Letër e konfirmimit .....	50

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27 shtator 2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Ferizajt.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç pagesave në 12 raste nga kategoria e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 364,680€, që komuna ka dështuar ti siguroj për çështje të auditimit. Edhe pse këto pagesa janë siguruar nga Thesari i Kosovës, mungesa e dëshmive përcjellëse si faturave, raporteve të pranimit apo edhe kontratave nuk ofron siguri për dhënën të mendimit, pasi Thesari bën ekzekutimin e pagesave duke u bazuar vetëm me urdhrin e prerë për përmbarim apo të gjykatës.

#### Theksim i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se në PFV janë prezantuar keq klasifikimi i shpenzimeve në vlerë 449,551€ pagesa këto sipas vendimeve gjyqësore apo të ekzekutuar nga Thesari. Po ashtu edhe shpalosjet e pasurisë dhe llogaritë e arkëtueshme nuk ishin prezantuar drejt në pasqyrat financiare vjetore.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



---

## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

## 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion të kualifikuar

Ne nuk ishim në gjendje të kryejmë procedurat e rregullta të auditimit për të marrë siguri në lidhje me pagesat të bëra nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe investimeve kapitale në vlerë totale prej 364,680€. Përkundër kërkesave të kohë paskohshme mungonin 12 pagesa që komuna ka dështuar ti ofroje duke i siguruar nga Thesari. Ne nuk kemi qenë në gjendje të vërtetojmë nëse janë ndjekur procedurat e duhura për ekzekutimin e këtyre pagesave, dhe për këtë arsye ne nuk ofrojmë siguri për ekzekutimin e tyre në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Ferizajt, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto

---

kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Gjatë vitit 2018, komuna ka paguar, regjistruar dhe prezantuar keq klasifikim të shpenzimeve në shumë prej 449,551€, pagesa këto të bazuar në vendime gjyqësore, dhe pasojë e mos planifikimit të duhur të buxhetit, si:
    - Nga kategoria e investimeve kapitale vlera prej 248,944€ ishte paguar për: 63,794€ për paga jubilarë për mësimdhënësit që dalin në pension, 170,824€ janë shpenzime për mallra dhe shërbime, si dhe 14,326€ për subvencione;
    - Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma 110,199€, ishte paguar për: 3,101€ paga jubilarë për mësimdhënësit që dalin në pension, 6,799€ për investime kapitale për mirëmbajtjen e rrugëve dhe 100,299€ për subvencione si mjete për ndihmë momentale financiare;
    - Nga kategoria e subvencioneve 18,000€ janë paguar për investime kapitale, shtrimin e rrugëve lokale; dhe
    - Komuna ka buxhetur dhe shpenzuar nga kategoria e subvencioneve 72,408€ të realizuara përmes prokurimit për furnizim me lopë, sera etj. Sipas Udhëzimit Administrativ UA 2005/08 këto pagesa duhet të regjistrohen si investime kapitale (transfere kapitale). Këto pagesa nuk ishin në përputhje me nenin 18.2.4 të Rregullores 01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike, planin kontabël dhe Udhëzimin Administrativ UA 2005/08 që përcakton klasifikimin shpenzimeve në kategori dhe kode adekuate.
  - Komuna nuk kishte vendos kontrollë në pranimin, protokollimin, shpërndarjen e dokumentacionit zyrtar. Si pasojë e mungesës së kontrollit komuna ka dështuar në ofrimin e dokumentacionit të nevojshëm për auditim. Edhe pas përpjekjes së auditorit që ti siguron dëshmitë e nevojshme të auditimit komuna nuk i ka siguruar 33 pagesa në vlerë 994,148€ si material të nevojshëm për auditim. Nga kjo për 21 raste dëshmitë janë siguruar nga Thesari, ndërsa janë edhe 12 raste që ende mungojnë dëshmitë, për të cilat komuna është përgjegjëse për posedimin dhe ruajtjen e tyre;
  - Llogarit e arkëtueshmet nga qiratë janë nënvlerësuar në vlerë 231,350€, taksat e biznesit janë mbivlerësuar në vlerë 1,045€, dhe nuk janë shpalosur të arkëtueshmeve nga çerdhet në vlerë 2,350€. Komuna nuk kishte shpalosur fare llogari të arkëtueshmeve nga lejet e ndërtimit, që komuna lejon pagesën në këste. Në mungesë të një raportit përmbledhës nga komuna për këto llogari, nga analiza e evidencave kjo llogari pritet të jetë 851,267€;
  - Neni 19, Pasuria kapitale ishte nënvlerësuar për shkak të pasurive të pa regjistruara ndërkaq pasuria jo kapitale nuk ishte shpalosur. Nga auditimi i 122 pagesave nga kategoria
-



e investime kapitale (pasuri të përfituara në vlerë prej 2,029,429€), janë regjistruar vetëm 24 transaksione apo 1,074,251€. Pjesa tjetër ka mbetur e pa regjistruar, për shkak të mungesës së bashkëpunimit në mes të financave dhe zyrtarit të pasurisë si dhe mungesës së dokumentacionit që mbështesin blerjen dhe regjistrimin e pasurisë. Pagesat për investime kapitale gjatë vitit 2018, në vlerë prej 9,741,757€<sup>1</sup>, komuna kishte arritur të evidentojë në regjistrin kontabël pasuri në vlerën prej 4,701,731€, ndërsa 5,040,026€, pagesa nga investimet kapitale nuk janë evidentuar si pasuri e përfitur gjatë vitit. Gjithashtu, komuna nuk ka arritur të zbatojë rekomandimin e vitit të kaluar për regjistrimin e plotë të pasurisë që ka në posedim 19 pagesa sipas vendimeve gjyqësore dhe banesat në pronësi të komunës, mbetur ende si të pa regjistruar në regjistrin kontabël. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këto çështje.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës së Ferizajt është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

---

<sup>1</sup> Në shumë përfshihet edhe keq klasifikimi i identifikuar në IK në vlerën 201,799€, ndërsa nuk përfshihen pagesat në mallra që i takojnë IK 6,799€, si dhe Subvencione që takojnë IK 90,408€. E pa konfirmuar ka mbetur shuma për mostrat e pa ofruara.

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike dhe 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë;
- Ligji i buxhetit për vitin 2018 numër 06/L-020;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës); dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK)

Lidhur me PFV-ve, përveç çështjes të theksuar te opinionin dhe keq klasifikimit të shpenzimeve, shpalosjeve jo e drejt e pasurisë dhe të arkëtueshmëve që kemi theksuar si çështje, kemi identifikuar edhe mos-pajtueshmërinë si në vijim:

- Neni 25, Raporti për numrin e punëtoreve sipas listës së pagave, komuna kishte shpалosur vetëm numrin e punëtoreve prej 2,321 sipas buxhetit ndërsa nuk kishte shpалosur numrin aktual të të punësuarve. Bazuar në listën e pagave të dhjetorit, komuna ka të evidentuar 2,463 punonjës;
- Neni 26, për shpалosjen e punëtoreve jo në listën e pagave komuna ka prezantuar dy punëtorë, ndërkaq sipas dëshmimeve të ofruar nga komuna vlerësojmë se punëtorët që nuk ishin pjesë përbërëse e listës së pagave janë 38 dhe këta punëtorë është dashur të shpалosen te neni 25 – si Punëtorët në listën e pagave, duke shpалosur arsyen për mos futjen në listën e pagave, sikurse do të duhej të shpалosen edhe borxhet për pagat e pa paguara (për më tepër shih çështjen A7);
- Neni 27, Raporti për numrin e të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta, janë prezantuar 188 të angazhuar. Bazuar në dëshmitë e ofruar nga komuna gjatë vitit janë evidentuar vetme 53 punëtorë duke mos bazuar faktin e prezantuar në PFV. Ndërsa bazuar në të dhënat e Thesarit (regjistri i furnitorëve), vlerësojmë se komuna ka angazhuar dhe paguar 246 punëtorë për shërbime intelektuale dhe shërbime kontraktuese tjera në vlerë prej 292,247€, të angazhuar në programet e përhershme të punës si ofiqarë, inspektorë, zyrtarë të lartë, regjistruar, anketues etj.

#### DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të theksuar te opinionin e auditorit, ekzistojnë gabime në prezantimin e drejte të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, dhe shpалosjet që janë prezantuar si theksim i çështjes.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit, si dhe atyre për theksim të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve dhe sigurimin e dëshmimeve për qëllime të auditimit. Në këtë aspekt më pas të gjitha shpenzimet duhet të paguhet dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e Ligjit të Buxhetit dhe LMFP. Më tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e pasurisë dhe shpалosjet në pasqyrat financiare.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2019 i adreson të gjitha çështjet. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi planifikimi, realizimin e buxhetit, të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsitë. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit dhe klasifikimi i duhur i shpenzimeve, eliminimi i parregullsive në aplikimin e ligjshmërisë për të hyrat e tatimit në pronë dhe qirave si dhe zbatimin e rregullave me rastin e planifikimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve me prokurim. Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të ulët për paranë e shpenzuar dhe në ndryshimet e pa autorizuara të projekteve. Gjithashtu, rendësi e veçantë duhet ti kushtetohet edhe menaxhimit të pasurisë që komuna ka në posedim dhe vendosjen së mekanizmave për menaxhimin e obligimeve dhe zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>29,248,881</b>	<b>30,080,857</b>	<b>29,502,713</b>	<b>27,058,456</b>	<b>25,258,562</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	24,391,691	24,549,077	24,530,367	22,090,820	21,376,372
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	-	589,523	530,391	1,524,372	729,319
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	4,553,220	4,553,220	4,416,274	3,363,343	3,020,666
Financimi nga huamarrja	303,970	326,086	4,362	-	-
Donacionet e brendshme	-	56,040	19,872	63,215	111,416
Donacionet e jashtme	-	6,910	1,447	16,706	20,789

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 831,976€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme (62,950€), të hyrave të bartura nga viti paraprak (589,523€), rritjes së fondeve nga financimi i huamarrjes (22,116€) dhe rritjes së garantit qeveritar 157,387€.

Në vitin 2018, OB ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 29,502,713€, me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2017.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>29,248,881</b>	<b>30,080,857</b>	<b>29,502,713</b>	<b>27,058,456</b>	<b>25,258,562</b>
Pagat dhe Mëditjet	15,222,016	15,151,631	15,081,908	14,514,631	14,323,589
Mallrat dhe Shërbimet	3,454,921	3,573,490	3,536,224	2,812,023	2,993,220
Shërbimet komunale	452,680	534,324	533,195	451,290	532,052
Subvencionet dhe Transferet	599,752	620,873	609,628	659,626	659,232
Investimet Kapitale	9,519,512	10,200,539	9,741,758	8,620,886	6,750,469

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Komuna ka përfituar rritje të grandit qeveritar bazuar në vendimin nr. 11/79 të datës 11.12.2018 në shumën prej 290,000€, për linjat buxhetore mallra dhe shërbime 40,000€; komunal 80,000€, subvencione dhe transfere 20,000€ si dhe shpenzime kapitale 150,000€; Gjithashtu, me vendimin e Qeverisë 07/80 datë 18.12.19 buxheti është zvogëluar në emër të kursimeve nga kategoria e pagave për 132,614€;
- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, 96% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për investime publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe disa projekte të reja për vitin aktual. Realizimi i treguar është ndikuar nga numri i madh pagesave bazuar në vendimet gjyqësore dhe pagesave direkte sipas nenit 39.2 të LMFPF;
- Shkurtimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 132,614€ ishte si rezultat i mos realizimit të fondeve të ndara. Ndërkaq rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin gjithashtu të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm prej 62,896€ dhe si dhe nga donatorët e jashtëm prej 2,400€ dhe shuma prej 40,000€ mjete shtesë me vendim të Qeverisë;
- Buxheti për komunal gjithashtu ishte rritur për 81,644€. Kjo shumë ishte alokuar për shkak të mbulimeve të borxheve aktuale dhe të trashëguara nga vitet paraprake;
- Komuna e Ferizajt ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët vendorë dhe të jashtëm në vlerën 62,940€, të cilat ishin alokuar për investime kapitale 56,040€, paga 3,870€, mallra dhe shërbime 2,400€ si dhe komunal 600€.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Ferizajt gjatë vitit 2018 ishin në vlerë 4,240,749€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtari të biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,553,220	4,553,220	4,240,749	3,450,803	4,199,493
<b>Totali</b>	<b>4,553,220</b>	<b>4,553,220</b>	<b>4,240,749</b>	<b>3,450,803</b>	<b>4,199,493</b>

Përpos të dhënave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë 1,033,454€ (dënimet në trafik 907,596€, të hyrat nga gjykatat 103,675€ si dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 22,183€). Të hyrave vetjake si të pa shpenzuar janë bartur për vitin 2019 në vlerë prej 917,061€.

---

**Çështja A1<sup>5</sup> - Parregullsi në kalkulimin e të hyrave nga tatimi në pronë**

**Gjetja** Bazuar në Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr.03/L-204 neni 9 precizon se “çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos që prona ose njësia e banimit që shërben si vend kryesor për banim, i lejohej zbritja prej dhjetëmijë euro (10.000€) nga vlera e tatueshme e pronës” Në 15 raste tatimpaguesve të njëjtë i janë njohur dy e më shumë prona si banim kryesor, kjo ka ndikuar që të hyrat në këto raste të nënvlerësohen për 398€. Kjo për shkak regjistrimit të tatimpaguesve me më shumë se një numër të identifikues, pakujdesisë së zyrtarëve të cilët bëjnë futjen e të dhënave në sistemin e Protax si dhe anketuesve në teren.

Nga 77 rastet e testuara, në një rast prona tatimore nuk ishte vlerësuar sipas zonave tatimore të përcaktuara në rregullore, tatimi për këtë pronë ishte përlllogaritur duke marrë për bazë zonën e III ndërsa sipas rregullores i takonte zonës së I. Kjo ka ndikuar në nënvlerësim të obligimit tatimor prej 22€.

**Rreziku** Situatat të kësaj natyre rezultojnë me ngarkesa të pasakta të tatimit në pronë dhe në këtë mënyrë dëmtojnë buxhetin e komunës në rastet e nënvlerësimit të obligimit tatimor apo dëmtojnë tatimpaguesin në rastet e mbivlerësimit të obligimit tatimor.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurohet që përmes menaxherit të tatimit në pronë të kërkojë që gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes jo vetëm regjistrimit të pronave të reja, por edhe ndryshimeve fizike që ndodhin në pronat ekzistuese në teren. Duhet të bëhet edhe korrigjimi i dobësive të identifikuar të cilat kanë të bëjnë me të dhënat e tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që kalkulim i tatimit të jetë i saktë.

---

<sup>5</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja.

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura.

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

---

---

## Çështja A2 - Regjistrim i të hyrave në kode jo adekuate

**Gjetja** Sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 44.1, Zyrtari Kryesor Financiar-ZKF i organizatës buxhetore, do të regjistrojë të gjitha transaksionet dhe do të mbaj regjistrat kontabël në përputhje me aktet nënligjore, gjithashtu sipas procedurave të MFK-së<sup>6</sup> Nr.7, pika 6.1.3 (i) Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) është përgjegjës për Regjistrimin ditor të të hyrave sipas kodeve adekuate ekonomike në SIMFK.

Gjatë testimeve tona ne identifikuam gabimet si në vijim:

- Të hyrat nga “lëshimi i lejeve mjedisore komunale” në shumë prej 115,339€ ishin regjistruar gabimisht në kodin ekonomik taksa komunale për “leje ndërtimi”;
- Të hyrat nga “taksa e regjistrimit të automjeteve” në vlerë 253,100€ ishin regjistruar gabimisht në kodin e “taksës rrugore”; ndërkaq
- Taksa për “ushtrimin e veprimtarisë” në vlerë prej 398,472€ ishte regjistruar në kodin ekonomik “licenca tjera për afarizëm”.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak se ZKF dhe zyrtari i të hyrave nuk i kanë kushtuar kujdes të mjaftueshëm kodifikimit të saktë të të hyrave me rastin e mbledhjes dhe regjistrimit të tyre në “FreeBalance”

**Rreziku** Mangësitë e identifikuar rezultojnë me pasqyrimin jo të drejtë të të hyrave sipas kodeve ekonomike dhe shpalosje të pa saktë të tyre në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi A2** Kryetari i Komunës duhet të kërkojë nga ZKF, drejtoritë që mbledhin të hyra që faturat me numër referent duhet të përfshihet drejtoria përkatëse që grumbullon të hyra dhe llojin e të hyrës brenda organizatës buxhetore. Po ashtu, ZKF duhet të bëjë përcjelljen e vazhdueshme të procesit të regjistrimit të të hyrave në SIMFK nëse bëhet sipas kodit përkatës të të hyrave në pajtim me planin kontabël.

---

<sup>6</sup> Rregulla financiare e Thesarit 01/2010-Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli, neni 1.



---

### Çështja A3- Mungesë e informatave në dosjet e tatimpaguesve

**Gjetja** Nga tetë rastet e audituara, në gjashtë prej tyre tatimpaguesit kishin marrë më shumë se një numër identifikues, në kundërshtim me nenin 14 të UA nr.03/2011 me rastin e regjistrimit të të dhënave në sistem nga operatorët merren këto të dhëna: numri i ndërtesës, numri i njësisë dhe numri i tatimpaguesit. Gjithashtu, neni 5.8 i të njëjtit udhëzim parasheh që dosjet e tatimpaguesve të përmbajnë edhe fotografitë e objekteve, nga tetë rastet e audituara dosjet nuk ishin kompletuar, mungonin fotografitë në disa<sup>7</sup> nga pronat e tatimpaguesve.

Kjo ka ndodh për shkak të neglizhencës të anketuesve në teren dhe dështimit të rishikimit të të dhënave të evidentuar në sistem, nga zyrtaret kompetent.

**Rreziku** Mangësitë e identifikuar në bazën e të dhënave dhe informatat e mangëta në dosjet e tatimpaguesve rezultojnë me gjendje jo reale të pronave të tatueshme dhe vështirëson kalkulimin e drejtë të tatimit.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e Tatimit në Pronë një plan të detajuar për të eliminuar dobësitë e identifikuara, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e plani duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuara. Vendosija e kontrollit, ri verifikimi, anketimi i pronave do të mundësonte eliminimin e dobësive në regjistrin e pronave dhe kalkulimin e drejtë të tatimit në pronë.

---

<sup>7</sup> Nga auditimi i 8 rasteve/tatimpagues të cilët kanë nga 3-18 prona, nga totali i 88 pronave, 49 s'kanë dëshmi/foto.

---

---

**Çështja A4 - Menaxhim i dobët i hapësirave publike të dhëna në shfrytëzim**

**Gjetja** Bazuar në rregulloren e të hyrave vetjake të Komunës së Ferizajt 01.Nr.137, ngarkesa për dhënien me qira të pronës komunale të hapur (pa objekte), për destinim jobujqësor, është mujore dhe përcaktohet në lartësi të ndryshme, varësisht nga zona e ndodhjes së pronës.

Me rastin e verifikimit në teren të hapësirave komunale/publike të dhëna në shfrytëzim të përkohshëm në sheshin kryesor të qytetit (së bashku me zyrtaret komunal), nga 10 rastet e ekzaminuar ka rezultuar se dy prej tyre kanë qenë duke operuar me kontratë të skaduar, kurse një pa kontratë. Sipërfaqja e kontraktuar për shfrytëzim ishte me e vogël se sipërfaqja faktike me një diferencë prej 183m<sup>2</sup>. Kjo ka ndikuar në nënvlerësim të obligimit të shfrytëzuesve dhe pamundësim të arkëtimit të të hyrave në llogari të komunës në shumë prej 732€/muaj, varësisht nga kohëzgjatja dhe sipërfaqja e shfrytëzimit të hapësirave publike.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së mekanizmave për zbatim të ligjit me qëllim të grumbullimit të të hyrave dhe shtimin fondeve.

**Rreziku** Mungojnë masa/mekanizma për zbatim të rregullave me qëllim të grumbullimit të hyrave dhe shtimin fondeve, që mundë të reflektojnë mungesë të mjeteve dhe rrezikojnë financimin e projekteve aktuale apo edhe projekteve të reja në dobi të qytetarit.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë të punëve në mes të Drejtorisë së Urbanizmit, Zhvillimit Ekonomik dhe Inspektoratit me qëllim të hartimit të një plan konkret për menaxhimi të pronave komunale. Të insistoj në marrjen e masave për moszbatim të kontratave apo harmonizimin e kontratave me gjendjen faktike të shfrytëzimit të hapësirave publike nga bizneset, në mënyrë që të eliminohen dobësitë e identifikuara dhe të rritet efikasiteti në menaxhimin e pronave komunale.

## Çështja A5- Shfrytëzimi i pronës komunale me kontrata të skaduar apo me kontrata që nuk janë në përputhje me ligjin

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përcaktohen të drejtat dhe obligimet e organevetë komunës në menaxhimin e pronës së paluajtshme të komunës, në raport me personat fizik dhe juridik, institucionet qendrore dhe AKP-në. Sipas nenit 5 dhe 6 dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë bëhet përmes procedurave të ankandit publik të cilat rregullohen me akt nënligjor. Nga pesë rastet e audituara, në dy raste nuk ishte zbatuar kërkesa ligjore për zhvillimin e ankandit publik dhe atë si në vijim:

Në njërin rast<sup>8</sup> kontrata edhe pse kishe skaduar me 01.05.2016, komuna kishte vazhduar të faturonte në bazë të kësaj kontratës. Kjo ka rezultuar me diferencë prej 15,100€ /për muaj, për shkak se çmimit i faturuar ishte 900€ sipas kontratës së skaduar, ndërsa nëse komuna do të vepronte në bazë të rregullores komunale, neni 11 për Ngarkesat për dhënien e pronës komunale me qira të hyrat e qirasë për një muaj do të ishin 16,000€.

Në rastin e dytë<sup>9</sup> kontrata ishte lidhur me 01.10.2014 duke mos aplikuar formën e ankandit në kundërshtim me procedurat e kërkuara nga ligji i lartë cekur me kohëzgjatje deri në zhvillimin e procedurave të ankandit publik, sot e asaj dite për pronën në fjalë nuk është hapur ankand<sup>10</sup>. Me 23.07.2018 komuna kishte nënshkruar aneks kontratë në kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-144.

Komuna nuk ka zhvilluar një sistem të brendshëm formal për menaxhimin e pronave komunale që ofrohen për shfrytëzim, monitorimin e kontratave sa i përket respektimit të kushteve dhe afateve kontraktuale.

**Rreziku** Anashkalimi i procesit të ankandit publik për dhënien me qira të pronës komunale rrit rrezikun e konkurrencës së hapur dhe mund të rezultojë me arkëtimi më të ultë të të hyrave.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurohet se prona publike e destinuar për tu dhënë në shfrytëzim bëhet përmes procedurës së ankandit publik. Gjithashtu, duhet të ndërmerren masa që kontratat ekzistuese me afat të skaduar të ndërpriten duke kërkuar paraprakisht shlyerjen e të gjitha obligimeve kontraktuale nga qiramarrësit.

<sup>8</sup> Hangar dhe sipërfaqe prej 40 ari në Rr. Rexhep Bislimi.

<sup>9</sup> Pronë komunale që gjendet tek rreth rrotullimi i rrugëve "Dardan Islami" dhe "Rruga e Reqakut" me sipërfaqe 600m<sup>2</sup>.

---

**Çështja A6 - Mosrespektimi i kontratës për ndryshimin e çmimit të qirasë****Gjetja**

Rregullorja e të hyrave vetjake të komunës, neni 11 parasheh që ngarkesa për dhënie me qira të pronës komunale të hapur (pa objekte), për destinim jobujqësor, është mujore dhe përcaktohet në lartësi të ndryshme, varësisht nga zona e ndodhjes së pronës. Sipas nenit 3 pika 2 e kontratës në mes komunës dhe qiramarrësit thuhet se shuma mujore e qirasë mund të ndryshojë si pasojë e ndryshimit të rregullores. Gjithashtu, edhe kontrate është lidh pa afat derinë zhvillimin e procesit të ankandit publik.

Në një rast, komuna kishte dhen në shfrytëzim të përkohshëm/ me qira një pjesë të pronës e cila gjendet te rreth rrotullimi i rrugëve D. Islami dhe rr. Reçakut. Sipas kontratës së nënshkruar në vitin 2014 shuma e llogaritur mujore për 600m<sup>2</sup> ishte 1,200€<sup>11</sup>. Prona e lartcekur gjendet në zonën e II dhe nëse dotë aplikohet Rregullorja e të hyrave vetjake që aplikohet edhe në 2018 ( bazuar edhe në nenin e kontratës 3.2 i cekur si me lartë) çmimi i përlllogaritur për muaj në këtë zonë konsiderojmë të jetë 1,800€. Nënvlërimi i të hyrave të komunës/obligimit të qiramarrësit në këtë rast për vitin 2018 është 7,200€.

Kjo ka ardhur si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës duke mos përshtatur çmimet e faturimit me çmimet e ndryshuara sipas rregullores së të hyrave vetjake bazuar në kërkesat e kontratës.

**Rreziku**

Kjo situatë ka shkaktuar ngarkesa të pasakta të qirave dhe në këtë mënyrë ka dëmtuar buxhetin e komunës duke rezultuar me më pak mjete monetare të cilat komuna do ti kishte në dispozicion.

**Rekomandimi A6** Kryetari duhet të kërkojë nga sektorët përgjegjës ti rishikojnë të gjitha kontratat në mënyrë që ndryshimet në rregulloren komunale të të hyrave vetjake të reflektojnë në ngarkesat e qirasë.

---

<sup>10</sup> Për shkak të ndërrimit të përfaqësuesit të biznesit (pronarit/qiramarrësit), komuna ka nënshkruar aneks kontratë me përfaqësuesin vijues, më të njëjtat kushte.

<sup>11</sup> Bazuar në rregulloren e të hyrave vetjake të komunës të vitit 2012.

---

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje gjatë viti 2018 ishte 15,151,632€, dhe ishte shpenzuar 99%.

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

---

#### Çështja A7 – Mos përfshirja e punëtorët të arsimit në listën e pagave dhe obligimet e pa prezantuar të pagave

**Gjetja** Komuna kishte nënshkruar kontrata pune me 38 mësimdhënës të cilët nuk ishin përfshirë në listën e pagave. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte parashikuar këto pozita të punës sipas buxhetit, pasi kishte shtuar nëntë (9) paralele, si pasojë e shtimit të numrit të nxënësve në klasat e X – dhjeta për vitin shkollor 2018/2019 që nuk ishin përfshirë në planifikimin vjetor. Këta të punësuar kanë punuar pa u paguar nga ana e komunës dhe komuna nuk kishte shpalos obligimin për pagat e tyre.

**Rreziku** Mos përfshirja e punëtorëve në listën e pagave rritë rrezikun që komuna të jetë objekt i padive nga të punësuarit për kompensim të pagave dhe të krijohen shpenzime shtesë për procedura gjyqësore dhe të përmbarimit. Gjithashtu, shpalosja jo e plotë e obligimeve, ndikon në nënvlerësimin e obligimeve dhe prezantimin jo të drejtë për shfrytëzuesi e PFV.

**Rekomandimi A7** Kryetari të sigurohet se me rastin e planifikimit rishikohen, analizohen situatat që kërkojnë staf shtesë, dhe kërkesat për vende pune dhe mjete buxhetore të përfshihen me kohë dhe aprovohen me ligjin e buxhetit, në të kundërtën të kërkohe nga organet relevante miratimi i këtyre pozitave dhe fondeve. Para se të merret vendimi për rekrutimi duhet të sigurohet pagesa dhe përfshirja në listën e pagave. Gjithashtu, të sigurojë se obligimet për paga janë prezantuar saktë.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 4,107,813€. Prej tyre ishin shpenzuar 4,069,419€ apo rreth 99%.

Rezultatet e auditimit tone për këtë fushë janë si me poshtë:

#### Çështja A8 - Anashkalim i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i parregullt i kontratës

**E gjetura** Komuna kishte hyrë në marrëveshje bashkëpunimit për shfrytëzimin e shërbimeve për përkrahje mediale në vlerë 600€/muaj me kohëzgjatje prej 24 muajsh, pa zhvilluar procedura të prokurimit. Marrëveshja ishte nënshkruar nga drejtori i financave duke tejkalluar kompetencat për nënshkrim të kontratës apo tejkalluar Ligjin e prokurimit publik, kërkesë e nenit 26.1 i cili përcakton se zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Për shkak të kontrolleve jo funksionale nuk ishte ndaluar certifikimi i kësaj pagese edhe pse ishte tejkalluar kompetenca për të lidhur marrëveshje dhe ishin anashkalluar procedura e prokurimit me këtë rast.

Gjithashtu, komuna përmes një OE ishte furnizuar me material administrativ për shkolla sipas vendimi të Ministrisë së Arsimit, me të cilin është lejuar që vetëm një kompani, të bënë botimin e këtij dokumentacioni. Komuna nuk kishte vepruar në përputhje me rregulloren për shpenzimin e parasë publike 01/2013 nenit 21 pasi ky shpenzim nuk përjashtohet nga prokurimi dhe nenit 26 - ekzekutimi i pagesave, kërkon të bashkëngjitet kontrata ku do të specifikoheshin çmimet e furnizimit sipas kërkesave të LPP për lidhjen e kontratës. Shkak ishte vendimi i MASHT i cili lejonte vetëm një kompani për botimin e dokumentacionit pedagogjik për shkolla për vitin 2017/2018.

**Rreziku** Mos aplikimi i procesit të prokurimit, zvogëlon transparencën për shpenzimin e parasë publike dhe komuna mund të marrë shërbime me çmime jo të favorshme (konkurruese) që reflekton në shpenzimin e parregullt të buxhetit për këtë kategori.

**Rekomandimi A8** Kryetari të sigurohet se zbatohet ligjshmëria për aplikimin e tenderimit të shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe monitoroj procesin e certifikimit të pagesave. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimin i marrëveshjeve apo kontratave për blerjen e shërbimeve, mallrave, bëhet nga personat përgjegjës/menaxheri i prokurimit.

#### Çështja A9 - Tenderimet jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftimin paraprak në AQP

---

**Gjetja** Komuna kishte zhvilluar jashtë planit të prokurimit procedurat e tenderimit për “Sistemin e referimit për menaxhimin e radhës për shërbimin të gjendjes civile”. Bazuar në nenin 8.2 të LPP kërkohet që në planin vjetor të prokurimit të përfshihen të gjitha procedurat që autoriteti kontraktues planifikon të tenderoj gjatë vitit fiskal. Gjithashtu, komuna nuk e kishte bërë njoftimin në AQP-s siç kërkohet me nenin 9.6 të LPP. Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur të kërkesave dhe nevojave për blerje.

Bazuar në raportin për realizimin e planit të prokurimit dhe kontratave të nënshkruara, (ofruar nga Zyra e Prokurimit) gjatë vitit 2018 janë realizuar 30 procedura të cilat nuk kanë qenë në planifikimin e prokurimit. Shkak për zhvillimin e këtyre proceduarve sipas komunës janë obligimet nga marrëveshjet e bashkëfinancim me nivelin qendror dhe nevojat e pa parashikuar të komunës.

**Rreziku** Tenderimet jashtë planit të prokurimit rezultojnë me shpenzim jo efikas të buxhetit të destinuar për qëllime tjera dhe gjithashtu pasqyrojnë mungesë të vlerësimit të nevojave dhe planifikim të dobët të kërkesave.

**Rekomandimi A9** Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë funksionale për planifikimin me kohë të nevojave për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha njësitë kërkuese dhe të njëjtat të përfshihen në planin e prokurimit që përgatitet nga zyra e prokurimit. Atëherë kur paraqiten nevoja për blerje jashtë planit duhet të vendosen mekanizma për njoftim paraprak të organeve relevante sipas kërkesave ligjore.

#### **Çështja A10 - Specifikimi teknik jo i qartë me rastin e tenderimi, pozicione të përsëritura dhe çmime jo normalisht të ulëta**

**Gjetja** Komuna ka zhvilluar procedura të prokurimit për Furnizimi me toner (ngjyrë për printer) me çmim 3,157€. Hartimi i specifikoni nuk është bërë në harmoni me nenin 28.2 të LPP i cili kërkon që Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit, pasi që brenda specifikimit teknik ka pozicione të paqarta dhe jo të specifikuar mirë/saktë, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomik të jenë në gjendje të kuptojnë së për çfarë tonerë

bëhet fjalë<sup>12</sup>. Vlejnë të theksohet që nga 75 artikuj respektivisht lloje të tonerëve, 67 prej tyre në ofertën financiare kishin çmimin 0.10€/njësi.

Gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate një shkollë ishte furnizuar me artikuj jashtë kontratës<sup>13</sup>, për të cilin nuk është specifikuar apo përcaktuar çmimi në ofertën financiare të kontraktuar. Ndërsa në të njëjtin rast furnizimi me toner ML-1640 për printer Samsung i cili ishte specifikuar në kontratë dhe kishte çmim prej 0,10€, komuna ka paguar 20€ për copë apo 80€ për furnizimin me 4 cope sipas faturës. Komisioni i pranimit dëshmon se janë pranuar mallrat sipas fletë dërgesave (të nënshkruar nga tre anëtarë), mirëpo gjatë ekzaminimit fizik në bashkëpunim edhe me zyrtaret komunal, tonerët që janë evidentuar në faturë nuk janë pranuar në tërësi, por janë pranuar zëvendësim apo tonerë tjerë për shkak se të njëjtit nuk ishin paraparë në ofertën fituese.

Si rezultat i mungesës së theksuar të kompetencës profesionale komuna nuk ka siguruar një listë të printerëve dhe fotokopjeve të cilat i disponon. Mosfunksionim efikas i kontrollit të zyra e prokurimit, ka sjell deri te publikimi i dosjes së tenderit me pozicione të paqarta apo të pa saktësuar të cilat reflektoje edhe furnizime me artikuj të pa kontraktuar.

### **Rreziku**

Dobësitë në qartësimin e pozicioneve në dosjen e tenderit rezulton me keq orientim të ofertuesve dhe mund të ndikoj në konkurrencën e mirëfilltë. Mos përfshirja e tërësishme e kërkesave për blerje sipas nevojave rrit rrezikun që komuna të furnizohet me mallra jo adekuate apo paraqitet nevoja edhe për kontratë shtesë.

**Rekomandimi A10** Kryetari të sigurohet se zyrtarët kompetent nga njësitë kërkuese hartojnë specifikacione teknike të qarta dhe të kompletuara bazuar në nevojat reale për prokurim. Gjithashtu, zyra e prokurimi të forcoj kontrollin duke u siguruar paraprakisht se kërkesat janë të plota dhe në dosjen e tenderit përfshihen pozicione të qartësuara saktë.

<sup>12</sup> Pozicioni 15- Ngjyrë printeri 49 kolor nuk dihet se për çfarë printeri apo fotokopje bëhet fjalë. Pozicioni 23- Ngjyrë për fotokopje "Ricoh" dhe pozicioni 35- Ngjyrë për Printer Epson, nuk është përcaktuar se çfarë tipi të fotokopjes Ricoh apo printerit Epson bëhet fjalë, ka shumë lloje të këtyre markave të fotokopjeve apo tonerëve. Pozicioni 43- Ngjyrë për Fotokopje Bizhup nuk është përcaktuar për cilin printer/fotokopje bëhet fjalë.

<sup>13</sup> Toner Ricoh MP 3353 ( 2\*30€=60€ sipas faturës).



---

**Çështja C1 - Mungesë e planit për menaxhimi të kontratave**

- Gjetja** Komuna nuk kishte vendosur kontrolle të mjaftueshme për menaxhimin e kontratave siç kërkohet me LPP neni 81.1.1 që menaxheret e caktuar të kontratës të hartojnë planin për menaxhim të kontratave. Në gjashtë raste, plani për menaxhimin e kontratës nuk ishte hartuar, për shkak të papërgjegjësisë së menaxhereve të kontratave dhe mbikëqyrjes jo efektive.
- Rreziku** Mungesa e planit për menaxhim të kontratave mund të rezultojë me menaxhimi të dobët të kontratave dhe redukton efektivitetin në arritjen e objektivave. Kjo rrite rrezikun e pagesave potencialisht të parregullta apo vlerë të ulët për para.
- Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim rreth dobësive të identifikuar, si dhe të analizojë pse nuk është aplikuar mbikëqyrja efektive e menaxhimit të kontratave. Duhet të sigurohet se kontrollet e vendosura, menaxheret e kontratave përgatitin dhe rishikojnë planin e kontratave sipas kërkesave ligjore.

**Çështja A11- Parregullsi në raportimin dhe angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbim të veçanta**

- Gjetja** Rishikimi ynë i angazhimeve të punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV) ka identifikuar këto dobësi:
- Bazuar në PVF, komuna ka shpallur 188 punëtor të angazhuar me MSHV. Nga zyra e personelit me kërkesën e auditorit janë prezantuar raportet/dëshmitë se vetëm 53 punëtorë kanë qenë të angazhuar me marrëveshje për shërbim të veçanta. Ndërsa bazuar në të dhënat e Thesarit (regjistri i furnitorëve), konsiderojmë se komuna ka paguar 246 punëtorë për shërbime intelektuale dhe shërbime kontraktuese tjera, në vlerë prej 292,247€.
- Sipas rregullës nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike neni 35.4.5 përcakton që organizata buxhetore duhet të plotësoj një formular në të cilin specifikohet që është zbatuar testi i marrëdhënies së punës dhe që individit nuk është në marrëdhënie pune dhe pagesa është blerje e shërbimeve për organizatën buxhetore. Në gjashtë raste të audituar, kemi identifikuar se ky test nuk është zbatuar me rastin e angazhimit. Gjithashtu, kemi identifikuar se angazhimi me marrëveshje për shërbime të veçanta kryesisht është bërë në programet e përhershme të punës si ofiqarë, inspektorë, zyrtarë të lartë, regjistruar, anketues etj.
- Rreziku** Mbulimi i pozitive të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rrit pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat. Gjithashtu, në mungesë të

konkurrencës së mirëfilltë, cilësia e shërbimeve të ofruara mund të jetë e nivelit të dobët dhe objektivat e organizatës të mos arrihen.

**Rekomandimi A11** Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave dhe akterët tjerë.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 620,873€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 609,628€. Ato kanë të bëjnë me subvencionime të ndryshme nga fusha e bujqësisë, kulturës, arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies etj.

#### Çështja A12 - Vonesa në liferim të mallit të blerë

**Gjetja** Komuna përmes prokurimit kishte tenderuar sera, lope dhe koshere bletësh për t'iu shpërndarë si subvencione përfituesve. Sipas nenit 2 të kontratës, kushtet e dërgesës është e përcaktuar data e fundit për furnizim.

- Te projekti "Furnizim i fermerëve me pesë sera me sipërfaqe prej 300m<sup>2</sup> dhe sistem të ujitjes" data e liferimit të mallit ishte 18 maj ndërkaq shpërndarja është bërë me 06 korrik;
- Te projekti "furnizim i fermerëve me lopë të racës së kombinuar mish-qumësht" shpërndarja është dashtë të bëhet më së largu me 02 dhjetor ndërsa është realizuar me 22 dhjetor.

Sipas zyrtarëve komunal shkak i vonesave ishin kërkesat e banorëve por ne nuk ishim në gjendje ta konfirmojmë këtë.

**Rreziku** Menaxhimi i dobët i kontratave ka rezultuar në vonesa të realizimit të objektivave të komunës.

**Rekomandimi A12** Kryetari duhet të sigurojë që kontrollet e vendosura për menaxhim të kontratave janë funksionale dhe obligimet kontraktuale realizohen brenda afatit kohorë.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,200,539€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 9,741,757€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e realizuara për shtrimin e rrugëve lokale, kanalizime, ujësjellës etj.

Për vitin 2018, kanë qenë të planifikuara 77 aktivitete të prokurimit sipas planit të prokurimit ndërkaq janë realizuar gjithsej 114 procedura për shkaka të planifikimit të dobët ku brenda një projektit përfshihen dy apo me shumë proceduar të prokurimit. Komuna nuk ka arrit të realizoj 32 proceduar të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2018, për faktin se disa nga këto aktivitete nuk janë iniciuar nga njësitë kërkuese si dhe mungesës së buxhet për shkak të obligimeve të shumta të komunës, apo harxhimit të fondeve përmes procedurave përmbartimore dhe pagesave nga Thesari.

Gjithashtu, edhe ndërrimi i qeverisjes komunale ka ndikuar në menaxhimin jo adekuat në realizimin e projekteve të planifikuara vite më parë.

#### Çështja B2 - Pagesa të projekteve nga buxhetet e projekteve tjera

##### Gjetja

Në 11 raste, komuna ka ekzekutuar pagesa duke mos siguruar paraprakisht aprovimin e Kuvendi Komunale për ri destinim të mjeteve. Në këto raste mjete ishin përdor nga projektet tjera duke anashkaluar kërkesën ligjore të Ligjit të Buxhetit neni 16 për aprovimin e asamblesë komunale për ri destinimin apo përdorimin të mjeteve të planifikuara nga një projekt për të realizuar pagesën për projektin tjetër. Kjo praktikë është ndjekur tek projektet:

- “Renovimi dhe meremetimi i objektit të gjykatës” tri pagesa në vlerë totale 10,346€ është paguar nga kodi i projektit për Rrethoja;
- “Pagesat për blerjen e tokave” në vlerë 184,859€ janë paguar nga “Ndërtimi i rrugëve lokale”;
- Pagesa në shumë prej 7,758€ për projektin “Asfaltimi e rrugës Rahovicë – Mirash”, ishte bërë nga projekti “Kanalizimi atmosferik dhe riasfaltimi i rrugës Hasan Prishtina”;
- Pagesa për projektin “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dardani” në vlerë 2,331€ është marrë nga projekti “Asfaltimi e rrugës Rahovicë – Mirash”;
- Pagesat e bëra për kontratën “Riparimi i rrjetit të kanalizimit fekal në komunën e Ferizajt” në vlerë 266,606€ janë paguar nga projektet “Asfaltimi i rrugës në lagjen Mustafa-Pleshinë e ulët” 56,399€; “Asfaltimi i rrugëve në fshatin e Vjetër” 70,000€; projekti “Lidhja e lagjes së Cakajve me shkollën në Meresalë” 24,409€; dhe “Aktivizimi i pishinës për të rritur dhe fëmijë” 115,798€. Kjo ka ndodhur për shkak të nënshkrimit të kontratave pa zotim të mjaftueshëm të fondeve apo edhe projekteve të pa planifikuara.

**Rreziku** Shfrytëzimi i fondeve pa miratimin paraprak të Kuvendit Komunal për ri destinim të mjeteve reflekton me kontrolle të dobëta në planifikim duke rrezikuar pagesën dhe realizimin e projekteve tjera të kontraktuar.

**Rekomandimi B2** Kryetari, fillimisht duhet të siguroj që në planifikimi përfshin të gjitha projektet që ekzistojnë mundësitë reale të realizohen dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për ekzekutimin e tyre. Gjithashtu, kontrollet duhet të jenë funksionale edhe në fazën e realizimit të projekteve, duke u siguruar paraprakisht se hyrja në obligime kontraktuale është përputhje me planifikimin e aprovuar dhe ka mjaftueshëm fonde të zotuar për realizimin e pagesave. Nëse paraqitet nevoja për ri destinim të mjeteve të sigurohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.

### Çështja A13 - Ndryshime në paramasën e projekteve të kontraktuar

**Gjetja** Në tetë (8)<sup>14</sup> raste e audituara, komuna ka ndryshuar paramasën e projekteve të kontraktuara pa aprovimin paraprak të ZKA-se, duke mos respektuar kërkesën e Udhëzuesit operativ të prokurimit neni 61.23 i cili parasheh që ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA dhe zotimit të mjeteve për kontratën e amandamentuar. Praktika e tillë ka ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur të projekteve para nënshkrimit të kontratës.

**Rreziku** Dobësitë në planifikim dhe realizim të aktiviteteve të prokurimit mund të ndikojnë negativisht në aspektin buxhetor dhe në zbatim të kontratave.

**Rekomandimi A13** Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, duke vendosur mekanizma efektiv për respektimin konsistent të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu, në raste se paraqitet nevoja për amandamentim të kontratës atëherë aprovimet parapake duhet të sigurohen nga personat përgjegjës bazuar në rregulla.

### Çështja A14 - Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit

**Gjetja** Në dy<sup>15</sup> nga shtatë rastet e audituara, komuna ka filluar procedua të prokurimit dhe ka lidh kontrata pa siguruar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit duke anashkaluar kërkesën e Ligjit të Prokurimit neni 28.10 i cili

<sup>14</sup> Kanalizimi fekal dhe asfaltimi I rrugës në lagjen e Dragoshve në Sojeve"; "Ndërtimi I kolektorit të ujerave të zeza prej Nikadini deri të vendi I shkarkimit"; "Asfaltimi I rrugës në fshatin Bibaj"; "Asfaltimi I rrugëve në fshatin Dardani"; "Asfaltimi nga rruga Brahim Ademi deri te Enver Topalli"; "Rregullimi I kanalizimit dhe asfaltimi I rrugës Qamil Ilazi".

<sup>15</sup> "Riparimi I kanalizimit dhe rrugës Halil Alidema" në vlerë 188,547€, "Rregullimi dhe zgjerimi I rrjetit të ndriçimit publik" në vlerë 34,223€.

---

definin qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedojë një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të proceduarve të kontraktimit të punëve. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së komunës lidhur me këtë problematike.

**Rreziku** Inicimi i procedure së prokurimit në mungesë të projektit rezulton me anashkalim të kërkesë ligjore dhe mund të rezultojë me realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara, studiuara dhe mund të afektoj shpenzim të paparashikuar apo ofroi vlerë të dobët për paranë e shpenzuar të taksapaguesit.

**Rekomandimi A14** Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e inicimit të proceduarve të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se njësit kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në rast të kundërt procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.

### 3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

---

#### Çështja A15 - Vonesa në pagimin e faturave

**Gjetja** Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Faturat e pranuar në shtatë raste, për mallra, shërbime dhe në 10 raste nga investimet kapitale nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor, për shkak të mungesës së mjeteve të buxhetuara.

**Rreziku** Vonesat në realizimin e pagesave rrisin rrezikun që komuna të jetë objekt i padive gjyqësorë dhe mund të bartë edhe shpenzime shtesë. Gjithashtu, mund të pasojnë edhe me pagesa direkt nga thesari që reflektojnë harxhimin e mjeteve që janë destinuar për qëllime tjera.

**Rekomandimi A15** Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

## Çështja A16 - Aneks i parregullt i kontratës kornizë dhe pagesa për punë të dyfishuara për rrugë të njëjta

**Gjetja** Për projektin “Shtruarja e rrugëve me zhavor dhe hapja e rrugëve të reja”, kontratë publike kornizë (25.09.2013-24.09.2015), me vlerën e paraparë të kontratës 99,990€, komuna kishte vazhduar punimet edhe pas përfundimit të afatit të kontratës duke u thirrur në aneks kontratë me vazhdim të afatit deri 25.10.2016, në kundërshtim me nenin 38.2 të LPP. Vlera e punëve të kryera prej 646,372€ (edhe për 2017) tejkalon edhe 30% e vlerës së kontratës kornizë, e cila nuk është e lejuar pasi LPP neni 38.2 parasheh që mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë për qind (30%), nëse urdhër blerjet e tejkalojnë këtë kufizim kontrata duhet të ndërpritet automatikisht.

Bazuar në situacionin e III dhe listën e rrugëve që janë mirëmbajtur kemi identifikuar se ka përsëritje të emrit të rrugëve duke bërë dyfishim të punës së kryer. Për 16 rrugët e dyfishuara sasia e zhavorrit arrinte 1,761 metra kub ose vlerën prej 20,252€. Raporti i pranimit të punimeve në shumë prej 496,371€, i nënshkruar nga menaxheri i projektit i takonte datës 11.10.2016, ndërkaq fatura ishte pranuar pas një (1) viti me datë 20.11.2017. Në raportin e përpiluar për Ekipin e auditimit nga mbikëqyrësi i projektit thuhet që në këto rrugë është intervenuar në pranverën e vitit 2016, mandej në të njëjtat është intervenuar edhe gjatë fushatës zgjedhore lokale të vitit 2017.

**Rreziku** Dobësitë e identifikuara tregojnë mos funksionim të kontrolleve në menaxhim të kontratave. Mungesa e funksionimit të mekanizmave për menaxhimin e kontratës mund të reflektoj me vlerë të dobët për paranë dhe humbje potenciale financiare.

**Rekomandimi A16** Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e dështimit të kontrolleve dhe të identifikojë faktorët që kanë shkaktuar problemet në realizimin e projekteve. Një ri dizajnim i kontrolleve efektive, në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret, duhet të sigurohet dhe të monitorohet në mënyrë sistematike nga ana e menaxhmentit.

## Çështja A17 - Tejkallim i vlerës dhe vazhdim i parregullt i kontratave kornizë për furnizime mallra, shërbime dhe punë

**Gjetja** Komuna ka nënshkruar vazhdimin, apo aneks kontratë për kontratat kornizë duke mos respektuar nenin 38.2 të Ligjit të Prokurimit Publik i cili nuk lejon vazhdimin apo aneks të kontratave për këto raste si në vijim:

- Kontratat kornizë e skaduar në qershor të vitit 2016 për “Informimin e qytetareve të Komunës për rrjedhën e seancave të Kuvendit Komunal përmes transmetimit të drejtpërdrejtë” në vlerë 37,500€, është vazhduar dhe komuna ende realizon shërbime bazuar në këtë kontratë;

- Kontratat kornizë e skaduar në shkurt të vitit 2017 për “Furnizim artikuj ushqimor dhe higjenik” në vlerë 38,515€ është vazhduar për një afat të paktuar duke realizuar furnizim sipas këtij vazhdim kontrate;
- Komuna për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të komunës- Qendra për punë sociale, kishte kontratë kornizë deri me 02.05.2017, të cilën kishte vazhduar më 10/05/2018 sipas kontratës bazë edhe për një afat të pakufizuar;
- “Mirëmbajtja e rrugëve me asfalt dhe trotualet Lot I dhe Lot II” të datës 02.10.2015 komuna nënshkruan Aneks kontratë (Vazhdim) të kontratës kornizë edhe për një (1) vit. Raporti i punëve të pranuar nga organi mbikëqyrës me datë 06.09.2016 në vlerë prej 174,295€, tregon se janë pranuar punë më tepër nga ajo e kontraktuar në vlerë prej 114,295€; dhe
- “Riparimi i rrjetit të kanalizimit fekal” është tejkualuar 30% i lejuar i vlerës së kontratës kornizë, siç parasheh neni 38.2 i LPP. Vlera e kontratës së nënshkruar është 59,250.00€ ndërsa janë pranuar punë në vlerë 375,109€. Vlera e tejkualuar arrin shumën prej 298,084€ apo rreth 387% (duke e nënkuptuar pjesën e 30%).

Kjo ka ndodhur për shkak se njësitë kërkuese nuk kanë dorëzuar në zyrën e prokurimit kërkesat për iniciimin e procedurave të reja të prokurimit dhe kryerja e detyrës jo me kompetencës nga ana e zyrës së prokurimit që ti njoftoj me kohë njësit kërkuese lidhur me skadimin e kontratave.

#### **Rreziku**

Vazhdimi i kontratave kornizë përveç që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, e pamundëson konkurrencën e lirë dhe për pasojë komuna mund të ketë shpenzim më të larta se sa kushtet e tregut.

**Rekomandimi A17** Kryetari duhet të siguroj se për të gjitha shërbimet apo furnizimet që kërkohet të zhvillohen procedura të prokurimit, iniciimi të fillohet në kohën të mjaftueshme dhe pagesat të realizohen vetëm atëherë kur furnizimi/ekzekutimi i punëve mbështetet me kontratë të vlefshme.

---

**Çështja B3 - Nënshkrimi i kontratave duke e tejkaluar vlerën e parashikuar të buxhetit****Gjetja**

Sipas Ligjit të prokurimit publik, neni 62, kërkohet që Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njëri nga arsyet, sipas pikës 1.2 nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për dhënien e aktivitetit të prokurimit. Ne kemi identifikuar se:

- Projekti “Ndërtimi i garazheve, depos dhe hapësirave të punës në Shtëpinë për Komunitete për persona me Aftësi të Kufizuar Mendore” – vlera e parashikuar dhe e buxhetuar ishte 21,305€ ndërsa kontrata është nënshkruar në vlerë 33,300€;
- “Rregullimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik- kontratë kornizë” vlera e parashikuar sipas njoftimit për kontratë ishte 108,000€ ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 34,224€ në muaj, për 36 muaj në shumë prej 1,232,078€. Sipas Ligjit të buxhetit ishin të planifikuara vetëm 700,000€;
- “Hartimi i projektit Bashkimi I Qytetit”, kontrata parashihet të arrijë vlerën 85,000€ derisa në buxhet janë paraparë 25,000€ për vitin 2018;
- “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Neredime e Epërme”, me kontratë tri vjeçare parashihet të arrijë vlerën 369,129€, në buxhet janë paraparë 130,000€.

Mjete të pamjaftueshme me buxhet kishin edhe projektet e bashkëfinancimit me nivelin qendror:

- Për projektin “Riparimi I kanalizimit dhe rrugës "Halil Alidemaj” në vlerë prej 154,813€, bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas Memorandumit të mirëkuptimit, ministria financon me 77,670€ ndërsa komuna 77,143€. Komuna kishte nënshkruar kontratë në vlerë 188,547€ e cila tejkalon shumën e parapare në memorandum për këtë projekt, derisa kishte ofruar deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve me vlerë të parashikuar prej 32,040€.



**Rreziku** Mos përfillja e këtyre kërkesave jo vetëm që anashkalon kërkesën ligjore por mund të rezultojë me hyrje në obligime pa siguruar fondet e nevojshme. Gjithashtu rritet rreziku i vonesave në zbatimin e kontratave dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të forcoj kontrollet duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim, dhe para nënshkrimit të kontratës të rikonfirmohet se mjetet janë në dispozicion.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna e Ferizajt kishte shpалosur në PFV pasuri kapitale në vlerë prej 206,185,073€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale në tre vitet e fundit ishte zero.

### Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

**Gjetja** Komuna e Ferizajt kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurive, mirëpo komisioni nuk kishte arritur ta përmbyll procesin siç parasheh rregullorja 02/2013, neni 19 dhe të nxjerrë një raport mbi ekzistencën dhe gjendjen e pasurive deri me 31.12.2018. Si rrjedhojë, rezultatet e inventarizimit nuk ishin reflektuar në PFV.

Komuna nuk e aplikon sistemin E-pasuria për regjistrim e pasurisë, duke bërë që pasuria jo kapitale në PFV të mos shpалoset në tri vitet e fundit. As menaxhimi i stokeve nuk ishte sipas kërkesave ligjore, duke pasur parasysh mungesën e një depoje, ne kemi vërejtur se komuna nuk aplikon procedura të hyrje-daljeve të materialit për zyrë.

**Rreziku** Dobësitë e identifikuar vështirësojnë menaxhimin adekuat të pasurisë dhe nuk prezantojnë gjendjen dhe vlerën reale të pasurisë me të cilat disponon organizata. Fakti i mos aplikimi të E-pasurisë në kushte të tilla, bënë që pasuria jo kapitale ti ekspozohet rrezikut për humbje, keqpërdorim apo tjetërsim.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013. Një komision i veçantë duhet të krijohet për të identifikuar boshllëqet e sistemit dhe për të siguruar se tërë pasuria është identifikuar dhe evidentuar në regjistrin e pasurisë.

## 3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2018 ishte

---

8,303,920€. Pjesa më të madhe e të arkëtueshmeve ishte nga tatimi në pronë prej 7,518,479.35€, taksat e biznesit prej 755,690€ dhe qiraja nga shfrytëzimi i pronës publike prej 29,752€.

---

### **Çështja C2- Vonesa në arkëtimin e qirasë**

**Gjetja** Sipas kontratave të nënshkruara nga ana e komunës si qiradhënës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, qiraja mujore duhet të paguhet më së largu deri në ditën e 5-të muajit rrjedhës.

Në katër raste nga pesë sa kemi audituar, kishte vonesa në shlyerjen e obligime të qiramarrësve ndaj komunës, në tre prej tyre komuna nuk kishte ndërmarr asnjë hap për arkëtimin e këtyre të hyrave. Shuma totale e borxhit që këta qiramarrës kishin ndaj komunës ishte 20,108€.

Mos gatishmëria për të ndërmarrë masa efikase për arkëtimin e të hyrave si dhe papërgjegjësia e qiramarrësve ka ndikuar në vonesa të arkëtimin të të hyrave.

**Rreziku** Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna në shfrytëzim rrit rrezikun që komuna të ketë një performancë të dobët në mbledhjen e të hyrave dhe mos realizim të planit si dhe rritjen e vazhdueshme të Llogarive të Arkëtueshme.

**Rekomandimi C2** Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në pajtim me kushtet e kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për faturimin dhe arkëtimin e mjeteve nga qiraja.

## **3.4 Obligimet e papaguara**

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 3,124,140€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Komuna vazhdon të ketë obligime të larta të pa paguar dhe dobësi në menaxhimin e obligimeve. Gjithashtu, në PFV komuna ka prezantuar edhe detyrime kontingjente (si paga jubilarë dhe kompensime të dëmit) prej 4,658,320€ të cilat janë rritur në krahasim me vitin e kaluar sa ishin prej 2,918,820€. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore me të cilat përballet komuna.

### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Ferizajt veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Nuk ka raporte cilësore të përgatitura nga prokurimi në lidhje me realizimin e kontratave të nënshkruara dhe krahasimin e tyre me planifikim të prokurimit si dhe mungojnë raportet për menaxhmentin nga zyra ligjore për detyrimet kontingjente. Menaxhimi financiar dhe kontrollika dëshmuar proces jo të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Në vlerësojmë se komuna nuk posedon planet strategjik, pasi dokumentet e kërkuar nuk na janë ofruar nga komuna.

Qeverisja në Komunë në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë negative. Komuna nuk ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe nuk ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Qarkullimi i dokumentacionit brenda komunës, bashkëpunimi dhe ruajtja e të dhënve dhe informatave lenë shumë për të dëshiruar. Auditimi i Brendshëm nuk kishte arritur të ofroj një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe pse kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit (KA).

### Çështja C3- Dobësi në funksionimin efektiv të NjAB-së dhe KA

**Gjetja** NjAB në planin vjetor kishte planifikuar 12 auditime, duke finalizuar nëntë raporte si dhe një raport shtese i cili nuk ishte pjesë e planit<sup>16</sup>. Në njërin prej raporteve të kryera “Procedurat e menaxhimit të prokurimit për periudhën 30.09.2017 deri 15.07.2018”, ishin dhënë vetëm përshkrime dhe të gjeturat nuk përkonin me objektiven e auditimit<sup>17</sup>.

Nga dhjetë raportet e finalizuar ishin dhënë gjithsej 34 rekomandime, prej tyre 10 ishin zbatuar, 13 ishin në proces ndërkaq 11 mbesin të pa zbatuara.

Gjatë vitit 2018 në periudhën janar-korrik, Komiteti i Auditimit (KA) ka mbajtur vetëm një takim. Ndërkaq me datë: 26.09.2018 është nxjerr vendimi për komitetin e ri i cili ka mbajtur katër takime por të cilat nuk janë formalizuar. Kjo e pamundëson verifikimin për shqyrtimit ose jo të raporteve të NjAB nga ana e KA.

**Rreziku** Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe si i tillë duhet të ofrojë siguri mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Një program i papërfunduar i NjAB-së dhe mos implementimi i rekomandimeve zvogëlon sigurinë që ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Një Komitet i Auditimit jo-funksional, nuk i shërben funksionit të auditimit dhe dobëson rolin dhe pavarësinë e auditimit të brendshëm. Kjo gjithashtu limiton mundësinë që menaxhmenti të marrë siguri për efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

<sup>16</sup> Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore në Mirëqenien Sociale për periudhën 01.01.2017 deri 01.08.2018.

<sup>17</sup> E gjetura ndërliidhet me mungesën e vendimit për pranim teknik në dosjen e tenderit.

**Rekomandimi C3** Kryetari duhet të sigurojë se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet dhe materializohet me ofrimin e sigurisë së arsyeshme se kontrollet operojnë në mënyrë efektive dhe ashtu siç janë dizajnuar. Për të arritur përfitimin maksimal nga auditimi i brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit dhe maksimizimin e punës së Auditimit. Komiteti duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

### Çështja B5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**Gjetja** Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, numër i konsiderueshem i projekteve për investime kapitale nuk janë realizuar. Vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme, dhe obligimet e mbetura, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Si rezultat i këtyre dobësive, disa prej projekteve as që kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata janë subjekt i shqyrtimeve gjyqësore. Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative.

Organizata gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

---

**Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Ferizajt ka rezultuar në 17 rekomandime kryesore. OB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjendja e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak ishte: pesë (5) rekomandime të pa zbatuara, rekomandime të pazbatuar të mbyllura janë pesë (5), tri (3) rekomandime në proces të zbatimit dhe vetëm katër (4) rekomandime të zbatuara.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarrë	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit, si dhe atyre për theksim të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve, përfshirë edhe shpalsjen e tyre. Në këtë aspekt më pas të gjitha shpenzimet duhet të paguhen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit. Më tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e të gjithë pasurisë si dhe të shpalsjet e tyre në pasqyrat financiare.</p> <p>Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2018 i adreson të gjitha çështjet. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e rekomandimit, përkundër mungesës së dëshmive për 13 pagesave.	Rekomandimi pazbatuar.
2	Te Hyrat	Kryetari duhet të ndërmarrë veprime për ta rishikuar vendimin për mundësinë e pagesave me këste, dhe të sigurojë se lejet e ndërtimit lëshohen vetëm pas përfundimit të pagesave të taksave në përputhje me legjislacionin për ndërtimet.	Komuna vepron sipas rregullave dhe ky rekomandim mbyllet.	Rekomandimi mbyllur i pazbatuar.
3	Te Hyrat	Kryetari i Komunës të sigurojë arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe në mënyrë aktive të shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandimi pazbatuar.

4	Te Hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet rreth mbledhjes së të hyrave kryhen në baza të rregullta mujore dhe të ndërmerr të gjitha aktivitetet e nevojshme juridike për arkëtim të taksës së biznesit.	Komuna kishte ndërprerë taksën për biznese, sfide mbetet arkëtimi i mjeteve të përmbledhura.	Rekomandim i pjesërisht zbatuar.
5	Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për ta shqyrtuar këtë proces të punësimit, si dhe të sigurojë kontrolle efektive në mënyrë që proceset e rekrutimit të bëhen në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të punës.	Auditori nuk ka identifikuar ndonjë gjetje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar.
6	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë që para pranimit të mallrave ose shërbimeve të formoj komision për pranimin e tyre. Më tutje të sigurojë se për secilën lëndë të ekzistojnë dëshmi sipas të cilave komisioni ka verifikuar nëse mallrat dhe shërbimet e pranuar janë në pajtim me kontraktimet për to.	Auditori nuk ka identifikuar ndonjë gjetje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar.
7	Mallra dhe Shërbime	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që para se të behën pagesat bazuar në kontratat për shërbime të veçanta, të ketë raport punë të nënshkruar nga mbikëqyrësit e autorizuar. Më tutje të sigurojë se për të gjitha kontratat për shërbime të veçanta, ndalet tatimi në burim në përputhje me legjislacionin.	Auditori nuk ka identifikuar ndonjë gjetje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar.
8	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që të para se të lidhet kontrata, kryesisht ato afatgjata të sigurojë se ka fonde të mjaftueshme për mbulimin e tyre.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pazbatuar.
9	Investime Kapitale	Kryetari, fillimisht duhet të sigurojë që ekziston një plan i qartë për projektet që priten të realizohen, përfshirë buxhetin e përafërt për realizimin e tyre, e më pas pagesat të bëhet bazuar në buxhetin e aprovuar për to. Në rast të nevojave për ndryshime në buxhet, paraprakisht duhet të merret vendimi nga kuvendi komunal, në përputhje me nenin 18, Ligji mbi Buxhetin.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pazbatuar.
10	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e financave në mënyrë që pagesat t'i behën në përputhje të plotë me kontratën,	Komuna ka ndërmarrë	Rekomandim i zbatuar.



		në llogaritë e OE-ve që kanë kontratë të lidhur me komunën.	ë veprim të nevojshme.	
11	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se për secilin projekt/kontratë të lidhur të paraprakisht të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratave. Më tutje për secilin projekt duhet të caktohet një organ mbikëqyrës i cili përcjellë punimet gjatë gjithë procesit.	Komuna ka filluar në caktimin e organeve mbikëqyrëse ndërkaq nuk ka vepruar mjaftueshëm sa i përket PMK.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
12	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se ka marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Më pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi. Gjithashtu, të sigurojë një depo në të cilën fillimisht do të pranohet malli, e pastaj do të shkarkohet përmes fletëdaljeve.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim (i evidentuar tek opinionin).	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
13	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, duke vendosur mekanizma efektiv për mbledhjen e të arkëtueshmeve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për arkëtim dhe ushtrimin e masave ligjore për mbledhjen e tyre.	Komuna ka filluar të shpërndaj njoftime dhe të aplikoj arkëtimin e detyruar në disa kategori (është theksuar si çështje).	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
14	Obligimet e papaguara	Kryetari i komunës duhet të siguroj kontrollë shtesë në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve. Fillimisht secila faturë e pranuar duhet të regjistrohet në	Komuna nuk ka ndërmarr	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.

		librin e faturave të pranuar. Pastaj për secilin muaj të raportohen faturat e papaguara. Më tutje komuna duhet të posedojë evidenca dhe dëshmi të plota për obligimet e papaguara.	ë ndonjë veprim (e kemi evidentuar te opinionin).	
15	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandimi mbyllur.
16	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të punojë me gjithë varësit e vet, për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Kryetari duhet të forcoj edhe më shumë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar.
17	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandimi pazbatuar.
Nr .	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		

1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit, si dhe atyre për theksim të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve dhe sigurimin e dëshmimeve për qëllime të auditimit. Në këtë aspekt më pas të gjitha shpenzimet duhet të paguhet dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e Ligjit të Buxhetit dhe LMFP. Më tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e pasurisë dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2019 i adreson të gjitha çështjet. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtaari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.
2	Te Hyrat	Kryetari duhet të sigurohet që përmes menaxherit të tatimit në pronë të kërkojë që gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes jo vetëm regjistrimit të pronave të reja, por edhe ndryshimeve fizike që ndodhin në pronat ekzistuese në teren. Duhet të bëhet edhe korrigjimi i dobësive të identifikuara të cilat kanë të bëjnë me të dhënat e tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që kalkulim i tatimit të jetë i saktë.
3	Te Hyrat	Kryetari i Komunës duhet të kërkojë nga ZKF, drejtoritë që mbledhin të hyra që faturat me numër referent duhet të përfshihet drejtoria përkatëse që grumbullon të hyra dhe llojin e të hyrës brenda organizatës buxhetore. Po ashtu, ZKF duhet të bëjë përcjelljen e vazhdueshme të procesit të regjistrimit të të hyrave në SIMFK nëse bëhet sipas kodit përkatës të të hyrave në pajtim me planin kontabël.
4	Te Hyrat	Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e Tatimit në Pronë një plan të detajuar për të eliminuar dobësitë e identifikuara, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e plani duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuara. Vendosja e kontrollit, ri verifikimi, anketimi i pronave do të mundësonte eliminimin e dobësive në regjistrin e pronave dhe kalkulimin e drejt të tatimit në pronë.
5	Te Hyrat	Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë të punëve në mes të Drejtorisë së Urbanizmit, Zhvillimit Ekonomik dhe Inspektoratit me qëllim të hartimit të një plan konkret për menaxhimi të pronave komunale. Të insistoj në marrjen e masave për moszbatim të kontratave apo harmonizimin e kontratave me gjendjen faktike të shfrytëzimit të hapësirave publike nga bizneset, në mënyrë që të eliminohen dobësitë e identifikuara dhe të rritet efikasiteti në menaxhimin e pronave komunale.
6	Te Hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se prona publike e destinuar për tu dhënë në shfrytëzim bëhet përmes procedurës së ankandit publik. Gjithashtu, duhet të ndërmerren masa që kontratat ekzistuese me afat të skaduar të

		ndërpriten duke kërkuar paraprakisht fshirjen e të gjitha obligimeve kontraktuale nga qiramarrësit.
7	Te Hyrat	Kryetari duhet të kërkojë nga sektorët përgjegjës ti rishikojnë të gjitha kontratat në mënyrë që ndryshimet në rregulloren komunale të të hyrave vetjake të reflektojnë në ngarkesat e qirasë.
8	Paga dhe Mëditje	Kryetari të sigurohet se me rastin e planifikimit rishikohen, analizohen situatat që kërkojnë staf shtesë, dhe kërkesat për vende pune dhe mjete buxhetore të përfshihen me kohë dhe aprovohen me ligjin e buxhetit, në të kundërtën të kërkohej nga organet relevante miratimi i këtyre pozitave dhe fondeve. Para se të merret vendimi për rekrutimi duhet të sigurohet pagesa dhe përfshirja në listën e pagave. Gjithashtu, të sigurojë se obligimet për paga janë prezantuar saktë.
9	Mallra dhe Shërbime	Kryetari të sigurohet se zbatohet ligjshmëria për aplikimin e tenderimit të shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe monitoroj procesin e certifikimit të pagesave. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimin i marrëveshjeve apo kontratave për blerjen e shërbimeve, mallrave, bëhet nga personat përgjegjës/ menaxheri i prokurimit.
10	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë funksionale për planifikimin me kohë të nevojave për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha njësitë kërkuese dhe të njëjtat të përfshihen në planin e prokurimit që përgatitet nga zyra e prokurimit. Atëherë kur paraqiten nevoja për blerje jashtë planit duhet të vendosen mekanizma për njoftim paraprak të organeve relevante sipas kërkesave ligjore.
11	Mallra dhe Shërbime	Kryetari të sigurohet se zyrtarët kompetent nga njësitë kërkuese hartojnë specifikacione teknike të qarta dhe të kompletuara bazuar në nevojat reale për prokurim. Gjithashtu, zyra e prokurimi të forcoj kontrollet duke u siguruar paraprakisht se kërkesat janë të plota dhe në dosjen e tenderit përfshihen pozicione të qartësuara saktë.
12	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim rreth dobësive të identifikuara, si dhe të analizojë pse nuk është aplikuar mbikëqyrja efektive e menaxhimit të kontratave. Duhet të sigurohet se kontrollet e vendosura, menaxheret e kontratave përgatitin dhe rishikojnë planin e kontratave sipas kërkesave ligjore.
13	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave dhe akterët tjerë.
14	Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të sigurojë që kontrollet e vendosura për menaxhim të kontratave janë funksionale dhe obligimet kontraktuale realizohen brenda afatit kohorë.

15	Investime Kapitale	Kryetari, fillimisht duhet të siguroj që në planifikimi përfshin të gjitha projektet që ekzistojnë mundësitë reale të realizohen dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për ekzekutimin e tyre. Gjithashtu, kontrollet duhet të jenë funksionale edhe në fazën e realizimit të projekteve, duke u siguruar paraprakisht se hyrja në obligime kontraktuale është përputhje me planifikimin e aprovuar dhe ka mjaftueshëm fonde të zotuar për realizimin e pagesave. Nëse paraqitet nevoja për ri destinim të mjeteve të sigurohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.
16	Investime Kapitale	Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, duke vendosur mekanizma efektiv për respektimin konsistent të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu, në raste se paraqitet nevoja për amendementim të kontratës atëherë aprovimet parapake duhet të sigurohen nga personat përgjegjës bazuar në rregulla.
17	Investime Kapitale	Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e inicimit të proceduarve të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se njësit kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në rast të kundërt procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.
18	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositorja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagës.
19	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e dështimit të kontrolleve dhe të identifikojë faktorët që kanë shkaktuar problemet në realizimin e projekteve. Një ri dizajnim i kontrolleve efektive, në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret, duhet të sigurohet dhe të monitorohet në mënyrë sistematike nga ana e menaxhmentit.
20	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se për të gjitha shërbimet apo furnizimet që kërkohet të zhvillohen procedura të prokurimit, inicimi të fillohet në kohën të mjaftueshme dhe pagesat të realizohen vetëm atëherë kur furnizimi/ekzekutim i punëve mbështetët me kontratë të vlefshme.
21	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të forcoj kontrollet duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim, dhe para nënshkrimit të kontratës të rikonfirmohet se mjetet janë në dispozicion.

22	Menaxhimi i Pasurisë	Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013. Një komision i veçantë duhet të krijohet për të identifikuar boshllëqet e sistemit dhe për të siguruar se tërë pasuria është identifikuar dhe evidentuar në regjistrin e pasurisë.
23	Llogarite e Arketueshme	Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në pajtim me kushtet e kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për faturimin dhe arkëtimin e mjeteve nga qiraja.
24	Auditimi i Brendshëm dhe KA	Kryetari duhet të sigurojë se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet dhe materializohet me ofrimin e sigurisë së arsyeshme se kontrollet operojnë në mënyrë efektive dhe ashtu siç janë dizajnuar. Përtë arritur përfitimin maksimal nga auditimi i brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit dhe maksimizimin e punës së Auditimit. Komiteti duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.
25	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm semenaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër e konfirmimit

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE TOSOBLIJA		
Datëse / Izlaze / Date / Datum	27.06.2019	
Nr. Orgje / Org. jed	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Faqes / Br. Strana
03	50	1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Agim Aliu *Aliu*  
Kryetar i Komunës

Data: 27.06.2019, Ferizaj,

